



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 90-të, të mbajtur më 04.08.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-2752/1 të datës 09.06.2023, **HIDHET POSHT.**

Lënda nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-2752 të datës 2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-2752/1 datë 09.06.2023 është formuar në bazë të kërkesës së paraqitur nga një parashtrues i panjohur. Denoncimi përmban pretendime të paqarta në lidhje me një lidhje të paligjshme të energjisë elektrike në ///. KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Nuk u paraqit asnjë provë në mbështetje të denoncimit.

Duke qenë se KSHPK-ja nuk ka mundësi të ofrojë të dhëna, informacione dhe dokumentacion shtesë, për të sqaruar akuzat, denoncimi është dashur të refuzohet. Kjo pasi lënda nuk ka elemente për veprim kompetent.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv.

Dorëzuar:
- Arkivi i RMV-së

Përgatiti: Mr. D.D
Miratoi: S:P:D

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETAR,
Biljana Ivanovska**